



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**

**Misioni në Kosovë**

**Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete**

**Seksionin për Monitorimin e Sistemit Juridik**

**Raport Tremujor**

**(Janar-Mars 2007)**

## TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
I. JANAR 2007 .....	8
A. Vështirësitë rreth marrjes së informatave lidhur me orarin e seancave dëgjimore publike dhe në qasjen e vendeve ku mbahen gjykimet mund të shkel të drejtën e të pandehurit në gjykim publik.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
B. Numri jo i duhur i gjyqtarëve porot prezent në procedurat për shkurorëzim shkel të drejtën në gjykatë të themeluar me ligj.....	9
II. SHKURT 2007 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
A. Paraburgimi përtej kufirit 72 orësh shkel ligjin vendor dhe të drejtën e persomit për liri.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
B. Mungesa e hetimeve efektive dhe ndjekja penale e veprave të pandehura penale mund të kenë shkelur standardin e përkushtimit të duhur .....	12
C. Vonesat në procedurat civile delays për shkak të problemeve rreth dërgesave të fletëhirrjeve gjyqësore të paditurve që banojnë jashtë territorit të Kosovës.....	14
III. MARS 2007 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Në bazë të mandatit të tij, Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik (SMSJ), pjesë e Departamentit për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete (DDNjDK) e Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian në Kosovë (OSBE), monitoron sistemin e drejtësisë duke vlerësuar pajtueshmërinë e tij me ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe duke rekomanduar zgjidhje të qëndrueshme për të siguruar që këto standarde të respektohen.

Ky raport është një koleksion i disa gjetjeve të vështruara nga OSBE-ja gjatë periudhës Janar-Mars 2007 dhe përmban rekomandime që i drejtohen gjyqësorit dhe institucioneve tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare për ndryshime pozitive në të ardhmen.

Gjatë muajit të parë të 2007-ës, OSBE ka përqendruar vëmendjen në shkeljen e së drejtës të të pandehurit për gjykim publik. Oraret e gjykimeve për procedurat penale dhe civile ende mungojnë apo nuk janë të azhurnuara nëpër shumë gjykata të Kosovës. Kjo situatë ndonjëherë madje edhe përkeqësohet për shkak të vështirësive rreth qasjes në vendet ku mbahen gjykimet.

Në shkurt 2007, OSBE ka hasur në disa dokumente dhe ka monitoruar disa raste penale të cilat qartësisht tregojnë se personat e arrestuar nga policia shumë shpesh mbahen në paraburgim përtej kufirit 72 orësh të paraparë me ligj, në shkelje të ligjit vendor dhe të drejtës së personit për liri. Analizat e bëra shkresave të lëndëve dhe monitorimit të rasteve civile gjatë këtij muaji kanë treguar se numri i gabuar i gjyqtarëve Porto prezent në procedurat për shkurorëzim shkel të drejtën në gjykatë të themeluar me ligj.

Në mars 2007 OSBE ka konstatuar raste në të cilat mungesa e hetimeve efektive dhe ndjekja penale e krimeve që pandehet të kenë ndodhur në Kosovë mund të ketë shkelur standardin e zellit të duhur. Sa i përket procedurave civile, OSBE ka vëzhguar vonesa të vazhdueshme për shkak të problemeve rreth dërgimit të fletëthirrjeve gjyqësore të paditurve të cilët banojnë jashtë Kosovës.

SMSJ do ta shpërndaj raportin e tij të parë tremujor të 2007-ës prokurorëve dhe gjyqtarëve në tërë Kosovën si dhe institucioneve tjera relevante (siç janë Ministria e Drejtësisë dhe Departamenti i Drejtësisë). OSBE ka kompletuar këto raporte dhe për disa vite, ja ka shpërndarë ato rregullisht gjyqësorit.

## I. JANAR 2007

### A. Vështirësitë rreth marrjes së informatave lidhur me orarin e seancave dëgjimore publike dhe në qasjen e vendeve ku mbahen gjykimet mund të shkel të drejtën e të pandehurit në gjykim publik.

OSBE është e brengosur për vazhdimësinë e vështirësive në të cilat hasin anëtarët nga publiku i përgjithshëm për të marr informata rreth datës dhe vendit të seancave dëgjimore publike në gjykata komunale dhe ato të qarkut. Për më shumë, OSBE është gjithashtu i brengosur se një gjykim penal është aktualisht duke u mbajtur në lokalet e burgut të Dubravës. Këto situata mund të shkelin të drejtën e të pandehurit në gjykim publik.

Mbajta e seancave gjyqësore publike përfaqëson një parim fundamental të mbrojtur nga ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.<sup>1</sup> Qëllimi i tij është që ta vë sistemin e drejtësisë në vlerësim të publikut dhe në këtë mënyrë t'i mbroj palët nga ushtrimi arbitrar i autoritetit shtetëror. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) ka gjetur se: “[n] një gjykim ka pajtueshmëri me parimin e publicitetit vetëm nëse publiku është në gjendje të merr informata lidhur me datën dhe vendin [...]”<sup>2</sup> Si pjesë e obligimeve të tyre që të sigurojnë publicitet për seancat dëgjimore, autoritetet duhet të sigurojnë që t'i ofrojnë publikut informata lidhur me datën dhe vendin ku ato mbahen.<sup>3</sup>

Për më tepër, edhe pse e drejta në gjykim publik nuk është absolute dhe në disa situata mediat dhe publiku mund të përjashtohen nga disa pjesë apo i tërë gjykimi<sup>4</sup> praktika gjyqësore e GjEDNj-së përcaktoi se mbajtja e gjykimit penal brenda burgut mund të shkel të drejtën në gjykim publik. Edhe pse nuk ka pengesa ligjore për pjesëmarrjen e publikut, aranzhimet e tilla të autoriteteve mund që në praktikë të pengojnë qasjen.<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Shih Nenin 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Fundamentale (KEDNj) dhe Neni 14(1), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP). Dispozitat për të drejtat e njeriut të parapara sipas KEDNj-së dhe KNDCP-së janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, 12 dhjetor 1999, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/57 të datës 27 tetor 2000, Neni 1.3.

<sup>2</sup> Shih vendimin në *Riepan v. Austrisë*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), 35115/97, 14 shkurt 2001, par. 29, dhe *Van Meurs v. Holandës*, Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Komunikata Nr. 215/1986, 13 korrik 1990, par. 6.2.

<sup>3</sup> *Riepan v. Austrisë*, id., par.30.

<sup>4</sup> Shih fusnotën e sipërme 1. KEDNj dhe KNDCP. Në vendimin *Campell dhe Fell v. Mbretërisë së Bashkuar*, 7819/77, 28 qershor 1984, par. 87-88, GjEDNj tha se mund të ketë arsye të mjaftueshme lidhur me qetësinë dhe sigurinë publike që do të justifikonin përjashtimin e mediave dhe publikut nga procedura, duke përfshirë këtu edhe rastet kur mund të ketë barrë jo-proporcionale mbi autoritetet që të zhvillojnë në publik disa procedura.

<sup>5</sup> Në *Riepan v. Austria*, id., par.28-29, GjEDNj thotë se: “[v]jetëm fakti se gjykimi u mbajt në zonën e Burgut Garsten domosdoshmërisht nuk qon të konkluzioni se i mungonte publiciteti. Njëjtë vlen edhe për faktin se në qoftë se spektatorët potencial do të duhej të kalonin nëpër kontrole të caktuara identiteti dhe sigurie nuk do të thotë se kjo do ta cenonte seancën nga natyra e vet publike [...]. Megjithatë, duhet të merret parasysh se Konventa ka për qëllim të garantoj jo të drejtat që janë teorike apo iluzore por të drejtat që janë praktike dhe efektive [...] GjEDNj konsideron se një gjykim ka pajtueshmëri me kërkesën e publicitetit vetëm nëse publiku është në gjendje të merr informata lidhur me datën dhe vendin dhe që ai të ketë qasje të lehtë në këtë vend. Në shumë raste këto kushte do të përmbushen nga fakti i thjeshtë që seanca është mbajtur në gjykatore të rregullt me hapësirë mjaft të gjerë për ta akomoduar audiencën. Me gjithë

Ligji i aplikueshëm i procedurës penale dhe civile në Kosovë kërkon që shqyrtimi kryesor të jetë publik, përderisa përjashtimi i publikut do të lejohet vetëm në disa rrethana të kufizuara.<sup>6</sup> Veç kësaj, Rregullorja mbi Aktivitetet e Brendshme të Gjykatave<sup>7</sup> parashohin vendosjen e përditshme të listës së seancave gjyqësore në tabelën e informatave në të cilën përfshihet data dhe vendi i seancës.<sup>8</sup> Në shkurt 2004, Departamenti i Drejtësisë (DD) lëshoi Qarkoren e Drejtësisë nr. 2003/7, e cila kërkon që administratorët dhe kryetarët gjykatave të sigurojnë që oraret e gjykimeve të shpallen në tabelën e buletinit për shikim publik në pajtim me nenin 76 të Rregullores mbi Aktivitetet e Brendshme të Gjykatave.<sup>9</sup>

Përkundër këtyre kërkesave ligjore, OSBE ka vështruar se një numër i gjykatave komunale dhe të qarkut në Kosovë vazhdojnë të dështojnë të shpallin për publikun oraret e plota dhe të azhurnuara për seancat publike gjyqësore, penale dhe civile.<sup>10</sup> Ky problem gjithashtu ndikon në veprimtarinë e gjyqtarëve ndërkombëtar. Shpesh, personeli në gjykata vendore nuk i publikon oraret e gjykimeve për seancat publike të kryesuara nga gjyqtarët ndërkombëtar, kryesisht për shkak se stafi ndërkombëtar nuk i ofron atyre informata të mjaftueshme lidhur me gjykimin. Kështu, në të shumtën e rasteve, e vetmja

---

këtë, Gjykata vështroi se mbajtja e gjykimit jashtë gjykatores së rregullt, në veçanti në një vend siç është burgu, në të cilin publiku i përgjithshëm nuk ka qasje, përfaqëson një pengesë serioze për karakterin e tij publik. Në rast të tillë, Shteti është i obliguar të ndërmer masa shtesë që të sigurojë se publiku dhe mediat janë të informuar në mënyrë të duhur lidhur me vendin ku do të mbahet seanca dhe t'u ofrohet qasje efektive.

<sup>6</sup> Nenet 328-331, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), 6 qershor 2003; Nenet 306-310, Ligji mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), Nr. 4/77, 36/80, 69/82.

<sup>7</sup> Rregullorja mbi Aktivitetet e Brendshme të Gjykatave (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Nr. 7/81).

<sup>8</sup> Neni 76, Rregullorja mbi Aktivitetet e Brendshme të Gjykatave.

<sup>9</sup> Shih par.5 të Qarkores së Drejtësisë 2003/7 të datës 4 shkurt 2004, e cila gjithashtu shton se këto orare duhet të shpallen në të gjitha gjuhët relevante në pajtim me nenet 9.3 dhe 9.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë. Vëni re se viti i referencës për këtë Qarkore të Drejtësisë gabimisht është shënuar 2003, edhe pse është miratuar me 2004.

<sup>10</sup> Për shembull, oraret e gjykimeve në Gjykatën Komunale të Prishtinës dhe Gjykatën e Qarkut në Gjilan nuk janë të publikuara fare. Veç kësaj, oraret e gjykimeve për seancat penale dhe civile në Gjykatën e Qarkut dhe atë Komunale në Pejë pothuajse nuk publikohen kurrë. Gjykata Komunale në Kamenicë nuk i ka të azhurnuara oraret e gjykimeve për seancat publike dhe në të shumtën e kohës nuk ka fare orare të gjykimeve. Në Gjykatën Komunale në Gjilan dhe në Gjykatën Komunale në Rahovec, oraret e gjykimeve të rasteve penale nuk publikohen rregullisht. Në Gjykatën Komunale në Viti oraret e gjykimeve nuk janë të azhurnuara; Gjykatat Komunale në Suharekë dhe Malishevë dështojnë t'i azhurnojnë rregullisht oraret e tyre të gjykimeve. Në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, një gjyqtar civil nuk e publikon orarin përderisa gjyqtari tjetër civil i publikon oraret rregullisht. Gjithashtu edhe në Gjykatën Komunale në Vushtrri disa gjyqtarë civil i publikojnë oraret e tyre të gjykimeve derisa disa gjyqtarë tjerë civil të po të njëjtës gjykatë nuk i publikojnë. Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka një tabelë brenda ndërtesës me orar të gjykimeve penale të publikuar vetëm në gjuhën shqipe. Në praktikë, megjithatë, është e paqartë nëse personat jashtë gjykatës janë në dijeni për ekzistencën e kësaj tablele, pasi që ajo është e vendosur në katin e parë, në një vend ku qasje nuk është e lehtë. Është më shumë në shërbim të administratorit që të përcaktoj cilat gjykatore janë të lira se sa t'i ofroj publikut informata mbi gjykimet. Ngjashëm, Gjykata e Qarkut dhe Komunale në Prizren i kanë tabelat e vendosura vetëm brenda ndërtesës (respektivisht në katin e parë dhe të dytin) në të cilat vendosen vetëm numrat e lëndës. Për më tepër, në përgjithësi njerëzit nuk mund të hyjnë brenda në gjykatë pa pasur fletëthirrje të gjyqit apo ndonjë tjetër justifikim.

mënyrë që të merret informacioni i nevojshëm është që personalisht t'i qasemi kryetarit të kolegjit që gjykon rastin (vendor apo ndërkombëtar), gjë që mund të mos jetë e përshtatshme për të garantuar publicitetin e seancës përkatëse.<sup>11</sup>

Praktikat e lartpërmendura ja bëjnë të vështirë publikut të përgjithshëm të merr informata mbi seancat publike penale dhe civile në gjykatat e qarkut dhe ato komunale. Edhe pse ndonjë anëtar i publikut i cili ka njohuri mbi sistemin përfundimisht mund të arrij te informata përkatëse, përpjekja enorme e kërkuar në shumë instance, mund që në mënyrë efektive të ndikoj si pengesë për të përcjell një gjykim. Si pasojë, kjo mund të ndikoj në dëm të së drejtës së të akuzuarit në gjykim publik.

Për më tepër, OSBE është i brengosur që kërkesat mbi të drejtën në gjykim publik mund të mos përfillen në gjykimin i cili është duke u mbajtur në burgun e Dubravës. Gjykimi përfshin trembëdhjetë të akuzuar të ngarkuar për kryerjen e disa veprave penale të ndërlidhura me terrorizëm, siç janë vrasja e një polici ndërkombëtar dhe një vendor që ndodhi më 23 Mars 2004<sup>12</sup> në rrugën që qon për Podujevë, vrasje në tentativë,<sup>13</sup> pjesëmarrje në organizatë terroriste,<sup>14</sup> dhe armëmbajtje pa leje.<sup>15</sup> Në bazë të procesverbalit, gjykimi ishte caktuar të mbahet më 09 korrik 2006 në Gjykatë e Qarkut në Prishtinë. Megjithatë, në të njëjtën ditë kolegji e shtyu seancën për shkak se “[...] Departamenti i Drejtësisë i PSSP-së, në bazë të Rregullores 2000/64 kishte dhënë rekomandim për ndërrim të vendit [...]”.<sup>16</sup>

Përfundimisht gjykimi u mbajt në ndërtesë përbrenda qendrës së paraburgimit në Dubravë përkundër shqetësimeve të shprehura nga Kryetari i Trupit Gjykes dhe disa nga mbrojtësit e të pandehurve. Avokatët mbrojtës u ankuan se shumicës së familjarëve të të pandehurve iu duhej të udhëtonin më shumë se 150 kilometra për të arritur në lokalet e burgut të Dubravës. Veç kësaj, disa nga avokatët pohuan se gjatë disa seancave, familjarët e të të pandehurve nuk kishin qasje në gjykatore.

Për atë që u tha më lartë, OSCE rekomandon që:

---

<sup>11</sup> Vlen të ceket se në shkurt 2007 Zyra e Gjyqtarëve Ndërkombëtar ka filluar që në objektin e Gjykatës Supreme të publikoj oraret javore të gjykimeve të kryesuara nga gjyqtarët ndërkombëtar.

<sup>12</sup> Neni 30 (2) pika 2 dhe 6, Ligji Penal i KSAK (LPK) Gazeta Zyrtare e KSAK-së Nr. 25/77 korrik 1977) e lidhur me Nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/12 mbi Ndalimin e Terrorizmit dhe Veprave Tjera të Ngjashme, 14 korrik 2001 dhe me Nenin 22, Ligji Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LPRSFJ), Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Nr. 44/76, 8 tetor 1976).

<sup>13</sup> Neni 30 (2) pikat 2 dhe 6, LPK lidhur me Nenin 2.1 dhe 2.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/12 dhe Nenin 19 dhe 22, LPRSFJ.

<sup>14</sup> Neni 5.3, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/12.

<sup>15</sup> Neni 8.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/7 mbi Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë, 21 shkurt 2001.

<sup>16</sup> Në bazë të procesverbalit të seancës së mbajtur më 09 korrik 2006. Për referencë të mëtejme, shih Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64 mbi Caktimin e Gjyqtarëve-Prokurorëve Ndërkombëtarë dhe/ose Ndërrimin e Vendit, 15 dhjetor 2000.

- Të gjitha gjykatat të ofrojnë informata lidhur me datën, orën dhe vendin e mbajtjes se seancave publike dëgjimore penale dhe civile, në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovës;
- Gjyqtarët ndërkombëtar t'i informojnë administratorët e gjykatave për gjykimet publike që ata do t'i mbajnë në gjykatat vendore, në mënyrë që të lejojnë publikim të shpejtë lidhur me gjykimet publike;
- Autoritetet vendore dhe ndërkombëtare të ndërmarrin të gjithë hapat e domosdoshëm për të garantuar qasje efektive të publikut në të gjitha seancat publike që mbahen në lokalet e burgut të Dubravës, si dhe lidhur me ndërrimin e vendit në gjykatat publike, në mënyrë që të ketë pajtueshmëri me ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

## II. SHKURT 2007

### A. Paraburgimi përtej kufirit 72 orësh shkel ligjin vendor dhe të drejtën e personit për liri

OSCE është e brengosur se në disa raste të monitoruara personat e arrestuar nga ana e policisë mbahen në paraburgim përtej kufirit 72 orësh të paraparë me ligj, në shkelje të legjislacionit vendor dhe të drejtës së personit për liri.

Në bazë të KEDNj-së “[a]skush nuk do të privohet nga liria përveç [...] në pajtim me procedurën e përshkruar me ligj [...]”.<sup>17</sup> Ligjshmëria e procedurës nënkupton se çfarëdo paraburgimi duhet të jetë në pajtim me ligjin vendor dhe KEDNj-në. GjEDNj-ja ka nënvizuar se kurdoherë që ka dështim në përmbushjen e kërkesave procedurale para çfarëdo privimi nga liria, arresti apo paraburgimi duhet që domosdoshmërisht të konsiderohen si jo të përshtatshme.<sup>18</sup>

KPPPK parasheh se “[n]jë person i privuar nga liria për shkak të dyshimit se ka kryer vepër penale do të sjellët shpejt para gjyqtarit dhe më së voni përbrenda 72 orëve nga arresti [...]”<sup>19</sup> dhe se paraburgimi i personit të arrestuar nga policia “[n]uk duhet të tejkalojë 72 orë nga koha e arrestit. Me kalimin e atij afati policia do ta liroj të paraburgosurin përveç nëse gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgimin.”<sup>20</sup>

Edhe përkundër kësaj kërkesë ligjore, OSBE ka monitoruar raste në të cilat personat e arrestuar janë sjell para gjyqtarit paraprak pas skadimit të kufirit 72 orësh të paraparë me ligj dhe kështu ishin lënë të paraburgosur përtej këtij kufiri, pa asnjë kontroll juridike.<sup>21</sup>

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prizren, më 16 tetor 2006 gjyqtari paraprak urdhëroi një muaj paraburgim për një të dyshuar i cili ishte arrestuar për akuza vjedhjeje.<sup>22</sup> Në bazë të procesverbalit të seancës për paraburgim që u mbajt në të njëjtën ditë dhe që filloi në ora 13:40, i dyshuari ishte arrestuar më 13 tetor 2006 në ora 13:50; megjithatë, dokumentet e policisë të cilat gjenden në shkresat e lëndës tregojnë se koha e arrestit nuk ka qenë më vonë se 12:30 të datës së 13 tetorit 2006. Vlen të ceket se disa

<sup>17</sup> Neni 5(1), KEDNj.

<sup>18</sup> Shih vendimi në *Van der Leer v. Holandës*, 11509/85, 21 shkurt 1990, para. 22 dhe vendimi *K.-F. v. Gjermanisë*, 25629/94, 27 nëntor 1997 para 63 dhe 69-73.

<sup>19</sup> Neni 14 (2), KPPPK.

<sup>20</sup> Neni 212(4), KPPPK.

<sup>21</sup> OSBE gjithashtu ka monitoruar disa raste në të cilat seancat dëgjimor paraburgim janë mbajtur në momentin e fundit para skadimit të kufirit 72 orësh. Kjo shkaktohet ose nga vonesat e policisë që t'i dorëzojnë prokurorit raportin përkatës policor ose nga vonesat e prokurorit që të parashtrajnë kërkesën për paraburgim para gjyqtarit përkatës paraprak.

<sup>22</sup> Neni 255(3), Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2003/25, mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), 6 korrik 2003,.



dokumente zyrtare nga shkresat e lëndës nuk raportuan në mënyrë korrekte mbi kohën fillestar të arrestit dhe të paraburgimit.<sup>23</sup>

Në një tjetër rast para Gjykatës së Qarkut në Pejë, dy të dyshuar ishin arrestuar dhe vënë në paraburgim më 18 gusht 2006 nën dyshim se kanë kryer veprën penale të vrasjes së rëndë.<sup>24</sup> Seanca dëgjimore për paraburgim u mbajt më 21 gusht 2006 pas skadimit të kufirit kohor prej 72 orëve.<sup>25</sup>

Dështimi në lirim të paraburgosurve pas skadimit të periudhës prej 72 orëve dhe seanca pasuese dëgjimore si dhe vendimi për paraburgim, në rastet e sipër-përmendura, janë bërë në shkelje të ligjit vendor dhe të së drejtës së personit për liri.

Për atë që u tha më lartë, OSBE rekomandon:

- Policia duhet që në mënyrë të shpejt të dorëzojë kallëzimin penal tek prokurori kompetent, sa më shpejt që është e mundur pas arrestit dhe vënies në paraburgim të një individit;
- Policia duhet ta liroj personin e arrestuar nëse brenda 72 orëve nga koha e arrestit nuk është mbajtur seanca dëgjimore mbi paraburgim;
- Prokurorët duhet t'i parashirojnë në formë të shkruar kërkesat e tyre për paraburgimin e individit të arrestuar, para gjyqtarit paraprak posa të pranojnë raportin e policisë;
- Gjyqtari paraprak nuk do të duhej të urdhëroj paraburgim në qoftë se seanca mbahet pas skadimit të kufirit kohor 72 orësh.

## **B. Numri i gabuar i gjyqtarëve porotë prezent gjatë procedurave për shkurorëzim shkel të drejtën në gjykatë të themeluar me ligj**

OSBE ka vërejtur se në një numër procedurash për shkurorëzim, përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, në shkelje të së drejtës për të pasur rastin e gjykuar para gjykatës së themeluar me ligj.<sup>26</sup>

---

<sup>23</sup> Urdhri për fillimin e hetimeve dhe vendimi mbi paraburgim i datës 16 tetor 2006 thotë se arresti ndodhi më 13 tetor 2006 në ora 13:50 (në bazë të raportit të cilin policia e shkroi në pajtim me nenin 207 (2) të KPPK-së, në kohën kur policia ia dorëzoi prokurorit rastin) Në shkresat përkatëse të lëndës OSBE nuk gjeti raportin e policisë mbi arrestin. Me gjithë këtë, procesverbali mbi dëgjimin e personit nga ana e policisë është bërë në orën 12:30. Kështu, ekzistojnë mospërputhje mes dokumenteve të ndryshme dhe ka elemente që të besohet se policia mund të ketë falsifikuar kohën e arrestit në mënyrë që t'i shmanget dëshmive për tejkalimin e kufirit 72 orësh.

<sup>24</sup> Neni 147 pika (3) dhe (11), KPPK.

<sup>25</sup> Ashtu si në rastin e më parë, gjyqtari paraprak kishte urdhëruar një muaj paraburgim.

<sup>26</sup> Shih Nenin 14(1), KNDKP, dhe Nenin 6(1), KEDNJ.

KEDNj parasheh se “[N]ë përcaktimin e obligimeve dhe të drejtave të tij civile [...] çdokush ka të drejtën në gjykim korrekt dhe publik brenda kohës së arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.”<sup>27</sup> Duke interpretuar këtë të drejtë, GjEDNj gjeti se gjykata duhet të jetë e përbërë në mënyrë të duhur “në pajtim me ligjin” dhe nënvizoi se shkelja ndodh kur gjykata nuk funksionon në bazë të ligjit të aplikueshëm procedural.<sup>28</sup>

Ligji i vjetër i aplikueshëm mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (LMMF)<sup>29</sup> thotë se “[k]olegji i përbërë nga gjyqtari dhe dy gjyqtarë porotë i udhëheq dhe i vendos procedurat e kontesteve martesore në nivelin e parë.”<sup>30</sup> Megjithatë, në bazë të ligjit të ri të Kosovës mbi familjen që ka hyrë në fuqi më 16 shkurt 2006,<sup>31</sup> “[k]olegji i përbërë nga një gjyqtar dhe tre gjyqtarë porotë, zhvillon procedurat dhe sjell vendimet në kontestet martesore.”<sup>32</sup>

Fillimisht, versionet në Anglisht dhe Serbisht të ligjit nuk përputheshin me versionin në Shqip i cili thotë se kolegji duhet të përbëhet nga një gjyqtarë profesional dhe dy gjyqtarë porotë.<sup>33</sup> Pasi që trupat gjykues në përgjithësi duhet të përbëhen nga numër tek në mënyrë që të arrihet vendim me shumicë votash, është më shumë e logjikshme që kolegji i gjyqtarëve në rastet e shkurorëzimeve të jetë i përbërë nga një gjyqtarë profesional dhe dy gjyqtarë porotë. Ky gabim është përmirësuar kohëve të fundit, pasi që në shkurt të vitit 2007 OSBE ka vërejtur se të gjitha tri versionet e ligjit thonë se kolegji duhet të jetë i përbërë nga “[n]jë gjyqtarë dhe dy gjyqtarë porotë”.<sup>34</sup> Është shqetësuese se UNMIK-u kurrë nuk e ka njoftuar publikun apo gjyqësorin për këtë ndryshim në ligj.

Për shkak të paqartësisë në ligj, OSBE ka vërejtur se në disa raste të shkurorëzimit kolegji nuk ishte i përbërë në pajtim me ligjin e ri të aplikueshëm në Kosovë mbi Familjen.<sup>35</sup>

Për shembull, në dy raste nga ligji i ri mbi familjen të parashtruara në gjykatë më 22 gusht dhe 12 tetor 2006, dhe të mbajtura pranë Gjykatës së Qarkut në Prizren që kishin të bënin me zgjidhje të martesës, në seancat e gjyqimit, të dyja të mbajtura më 27 dhjetor 2006, nuk kishte gjyqtarë porotë prezent.<sup>36</sup>

<sup>27</sup> Shih KEDNj, Neni 6(1).

<sup>28</sup> *Zand v. Italisë*, Raport i Komisionit Nr. 7360/76, 1978 dhe *Rossi v. Francës*, Raport i Komisionit Nr. 11879/85, 1989.

<sup>29</sup> Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, Nr. 10/84).

<sup>30</sup> Neni 333, Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare.

<sup>31</sup> Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 2004/32 (miratuar përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/7, *Mbi Miratimin e Ligjit mbi Familjen i adoptuar nga Asambleja e Kosovës*, 16 shkurt 2006).

<sup>32</sup> Neni 73, Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 2004/32, versioni në anglisht dhe serbisht.

<sup>33</sup> Neni 73, Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 2004/32, versioni origjinal në shqip.

<sup>34</sup> Neni 73, Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 2004/32.

<sup>35</sup> Çështja e përgjithshme rreth mungesës se gjyqtarëve porotë në procedurat civile është raportuar nga OSBE-ja në disa raste të mëparshme. Shih Raportin e OSBE-së “Administrimi i Drejtësisë në Gjykatat Komunale” (mars 2004), fq. 18. Shih gjithashtu raportet mujore të Departamentit për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete (ish Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimit të Ligjit) pranë OSBE-së për muajt janar 2005, dhe shkurt 2006.

<sup>36</sup> Në të dyja rastet, procesverbalet e gjykatës përfshijnë emrat e dy gjyqtarëve porotë që mungonin, në vend të tre gjyqtarëve porotë që duhej të merrnin pjesë siç kërkohej nga ligji i ri..

Në shembullin e tretë para Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë që përfshinte një padi për shkurorëzim të parashtruar në gjykatë më 5 maj 2006, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur më 24 maj 2006, vetëm dy gjyqtarë porotë në vend se tri ishin prezent, në kundërshtim me versionet në anglisht dhe serbisht të Ligjit të ri mbi Familjen që ekzistonin në atë kohë.

Dështimi në përbërjen e duhur të kolegjeve gjyquese në dy rastet e para të shkurorëzimit ishte në shkelje të ligjit vendor dhe të së drejtës në gjykatë të themeluar me ligj. Veç kësaj, avokatët që i përfaqësonin palët nuk e kundërshtuan përbërjen jo të duhur të kolegjeve. Megjithatë në shembullin e tretë, gjykata dhe avokatët nuk mund të fajësohen për përbërjen jo të duhur të kolegjit, por autoritetet përkatëse që miratuan një ligj me përkthime kontradiktore për sa i përket përbërjes së trupi gjyques.

Për atë që u tha më lartë, OSBE rekomandon që:

- Instituti Gjyqësor i Kosovës të ofrojë trajnime për gjyqtarë mbi Ligjin e ri të Kosovës për Familjen;
- Oda e Avokatëve të Kosovës t'ua rikujtojë mbrojtësve aplikimin e ligjit të ri mbi familjen dhe rolin e tyre që të sigurojnë përbërjen e duhur të trupave gjyques;
- UNMIK-u duhet ta bëjë publike vërejtjen për ndryshimin në Ligjin e ri mbi Familjen dhe të sqaroj se në bazë të Ligjit të ri mbi Familjen, në rastet e shkurorëzimit prezent duhet të jenë dy gjyqtarë porotë dhe një gjyqtarë profesional.

### III. MARS 2007

#### A. Mungesa e hetimeve efektive dhe ndjekja penale e krimeve të pandehura mund të kenë shkelur standardin e përkushtimit të duhur

OSBE është e brengosur për mungesën e hetimeve efektive dhe ndjekjen penale kur pandehet se ka gjasa të jetë kryer një veprë penale. Mbase, në disa raste autoritetet përkatëse dështuan të zbatojnë standardin e kërkuar të përkushtimit të duhur të paraparë me ligjin për të drejtat e njeriut.

Në bazë të praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së<sup>37</sup> çfarëdo kundërpërgjigje me dhunë ndaj një personi të privuar nga liria që nuk është bërë domosdoshmërisht e nevojshme bazuar në sjelljen e të paraburgosurit, në parim është shkelje e nenit 3 të KEDNJ-së,<sup>38</sup> sepse e përul dinjitetin njerëzor të individit përkatës.

Për më shumë, mbrojtja e të drejtave të njeriut në rastet e trajtimit johuman dhe përulës, vlen për mbrojtjen e individëve si nga veprimet e personave privat ashtu edhe atyre zyrtar. Autoritetet e kanë për detyrë të demonstrojnë përkushtim të duhur në hetimin, mbrojtjen dhe dënimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut..<sup>39</sup>

Legjislacioni vendor në Kosovë thotë që “[p]rokurori publik do të filloj hetimet [...] nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se një person ka kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare..”<sup>40</sup>

Megjithatë, OSBE ka monitoruar raste në të cilat autoritetet kanë dështuar të hetojnë në mënyrë të duhur rastet e trajtimeve johumane dhe degraduese dhe/ose veprimet e pandehura kriminale të kryera nga individët zyrtar apo privat.

Në një rast të hetuar nga Prokuroria e Qarkut në Prizren, më 25 tetor 2006, policia kishte arrestuar një pjesëtar të komunitetit Roma të Kosovës në lidhje me një dhunim të kryer ndaj një vajzë 13 vjeçare. Gjatë marrjes së parë në pyetje nga ana e policisë, i pandehuri pranoi se kishte kryer veprën penale. Megjithatë, më 27 tetor 2006, i pandehuri deklaroi para prokurorit të qarkut në Prizren se ai pranoi të ketë kryer veprën penale vetëm sepse policia i ishte kërcënuar dhe e kishte rrahura atë.<sup>41</sup> Ai gjithashtu i tregoi edhe rrobat e shqyera si shenja të dukshme për keqtrajtimin e pandehur. Viktima e dhunimit të pandehur, në deklaratën e saj të dhënë para prokurorit më 01 nëntor 2006, konfirmoi se ajo ishte dëshmitare e keqtrajtimin të policisë të kryer ndaj të pandehurit. Përkundër kësaj,

<sup>37</sup> Vendimi në *Tekin v. Turqisë*, 22496/93, 9 qershor 1998, para. 531; vendimi në *Ribitsch v. Austrisë*, 18896/91, 4 dhjetor 1995, para. 38.

<sup>38</sup> “Askush nuk do të jetë objekt i torturës apo trajtimit johuman dhe degradues.”

<sup>39</sup> Komenti i përgjithshëm Nr. 31, Komiteti i KB-ve për të Drejtat e Njeriut, *Natyra e Obligimit të Përgjithshëm Ligjor e Vendosur mbi Shtetet Anëtare në Konventë*, 26 maj 2004 (CCPR/C/21/Rev.1/Add.13), par. 8.

<sup>40</sup> Neni 220(1), KPPPK.

<sup>41</sup> Dëshmitë e mbledhura me përdorim të dhunës janë të papranueshme dhe vendimet e gjyqit nuk mund të bazohen në to. Shih Nenet 153 dhe 155, KPPPK.

prokurori dështoi t'i filloj hetimet për keqtrajtimin e pandehur. Në vend të kësaj, gjyqtari paraprak urdhëroi një muaj paraburgim për të pandehurin.<sup>42</sup>

Në një rast tjetër në Ferizaj, më 20 nëntor 2006 prokurori publik komunal e hodhi poshtë një kallëzim penal të policisë<sup>43</sup> të datës 03 nëntor 2006 i cili tregonte se një burrë kishte keqtrajtuar fizikisht gruan e tij dhe i kishte shkaktuar asaj lëndime, duke kryer kështu një krim i cili sipas detyrës zyrtare do të duhej të ndiqej penalisht.<sup>44</sup> Në bazë të informatave që kishte mbledhur policia, në mes të qiftit kishte pasur incidente dhune edhe para ngjarjes në fjalë.

Në vendimin me të cilin hodhi poshtë kallëzimin penal,<sup>45</sup> prokurori e interpretoi gabimisht legjislacionin aktual të zbatueshëm dhe gjeti se të dyja palët kryen "Dhunë Familjare", një vepër penale e cila nuk ekziston.<sup>46</sup> Veç kësaj, vendimi mbi hedhjen poshtë tha [v]epura penale ( e *Dhunës Familjare – v.e.a.*) nuk është në mes të veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare."<sup>47</sup>

Në përmbledhje, prokurorët kanë dështuar që në mënyrë të shpejtë t'i hetojnë dhe ndjekin penalisht trajtimet e mundshme johumane dhe degraduese si dhe veprimet kriminale. Kjo shkel standardin e përkushtimit të duhur dhe obligimet ligjore të prokurorëve të parapara me ligj vendor.

Rrjedhimisht OSBE rekomandon:

- Prokurorët të hetojnë në mënyrë të shpejtë, dhe nëse është e nevojshme, t'i ndjekin penalisht dhe me përkushtimin e duhur, zyrtarët e policisë të cilët i keqtrajtojnë personat e arrestuar dhe të paraburgosur;
- Prokurorët të hetojnë në mënyrë të shpejtë, dhe nëse është e nevojshme, t'i ndjekin penalisht dhe me përkushtimin e duhur, personat të cilët kanë kryer vepra penale siç është lëndimi i lehtë trupor në kontekst të dhunës familjare;
- Njësitë për Inspeksion Gjyqësor t'i hetoj dy rastet e sipërpërmendura.

---

<sup>42</sup> Vlen të ceket se disa dokumente në dosjen e prokurorisë tregojnë mungesë të dyshimit të arsyeshëm kundër të dyshuarit. I pandehuri kishte punuar gjatë ditës kur pandehet të ketë ngjarë vepra penale, kështu që është e mundur që ai të ketë pasur mbrojtjen e alibisë. Veç kësaj, edhe pse ka dëshmi të dhunimit, mostrat e lëngjeve trupore nuk ishin marrë nga viktima.

<sup>43</sup> Shih Nenin 208, KPPK..

<sup>44</sup> Për shembull, i pandehuri mund të jetë fajtor për Lëndime të Lehta Trupore nën Nenin 153, KPPK. Kjo vepër nuk është nga ato vepra penale të cilat ndiqen në bazë të kërkesës së palës së lënduar.

<sup>45</sup> Shkresat e lëndës nuk përmbajnë certifikatë mjekësore apo çfarëdo kërkesë për dokument të tillë.

<sup>46</sup> Shih Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/12 Mbi Mbrojtjen kundër Dhunës Familjare, 9 maj 2003. Vepra penale Lëndim i Lehtë Trupor, si i kryer brenda ose jashtë, apo në kontekst të dhunës familjare duhet që menjëherë të ndiqet penalisht. Id. Neni 16.2; shih Neni 153, KPPK.

<sup>47</sup> Përkthim i OSBE-së - jozyrtar i pjesës përkatëse të vendimit të prokurorit e datës 20 nëntor 2006.

## **B. Vonesat në procedurat civile për shkak të problemeve rreth dërgimit të fletëthirrjeve gjyqësore për të paditurit që banojnë jashtë Kosovës**

OSBE është e brengosur se shtyrjet e vazhdueshme të seancave gjyqësore për shkak të problemeve rreth ftesës së palëve që banojnë jashtë Kosovës i vonon procedurat civile dhe mund të qoj te shkelja e së drejtës për të pasur rastin e gjykuar brenda kohës së arsyeshme.<sup>48</sup>

Procedura e rregullt e ftesës gjyqësore, siç është e përcaktuar me Ligjin mbi Procedurën Kontestimore<sup>49</sup>, kryhet përmes shfrytëzimit të shërbimit postar, ose në disa raste, përmes anëtarit të caktuar nga personeli i gjykatës (në rate tipike – përmes korrierit të gjykatës)<sup>50</sup>. Në rastet kur palët ose dëshmitarët banojnë jashtë territorit të Kosovës, Qarkorja e Drejtësisë 2003/03 mbi *Ndihmën Ligjore Ndërkombëtare në Çështjet Civile dhe Penale* e lëshuar nga Departamenti i Drejtësisë (DD) ë 5 shtator 2003, thotë se kërkesa për dërgimin e fletëthirrjeve gjyqësore duhet të parashtrohet në formë të shkruar dhe t'i adresohet Drejtorit të DD-së.<sup>51</sup> Drejtori do të ja përcjell kërkesën autoriteteve relevante në shtetet përkatëse.<sup>52</sup> Gjykatat duhet të lejojnë periudhë kohore prej së paku tre deri katër muaj për procedimin e kërkesës.<sup>53</sup>

OSBE ka monitoruar raste të shumëfishta ku vonesat e tepërta kanë ndodhur në procedurat civile për shkak të problemeve rreth ftesës së palëve që banojnë jashtë Kosovës. Kjo tregon se procedura e sipër-përshkruar është jo praktike dhe nuk funksionon si duhet.

Rigjykimi që kishte të bënte me një kontest pronësor pranë Gjykatës Komunale në Mitrovicë filloi më 16 korrik 2004. Seanca e parë më 22 shtator 2005 ishte shtyrë sepse i padituri i cili banon në Serbi nuk ishte ftuar në mënyrë të rregullt. Rrjedhimisht, më 11 tetor 2005 gjykata kërkoi nga DD-ja që ta ftoj mbrojtësin e të të paditurit në Serbi. Seancat tjera të datave 27 dhjetor 2005 dhe 8 maj 2006 gjithashtu ishin shtyrë për shkak se, sipas gjyqtarit, nuk kishte prova se të paditurit i ishte dërguar ftesa. Seanca tjetër e datës 14 shtator 2006 ishte shtyrë për shkak se DD-ja kishte informuar gjykatën<sup>54</sup> lidhur me një letër të Ministrisë së Drejtësisë në Serbi të datës 8 mars 2006. Kjo letër sqaronte se autoriteteve serbe do t'i duhej më shumë kohë ta procedoj kërkesën dhe për këtë arsye DD-ja do të duhet ta ri-parashtroj kërkesën për Ndihmë Ligjore Ndërkombëtare (NLN).

<sup>48</sup> Neni 6(1), ECHR.

<sup>49</sup> *Fusnota e Sipërme 6.*

<sup>50</sup> Shih Nenin 133, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

<sup>51</sup> Qarkorja e Drejtësisë 2003/03 aplikohet si për kërkesat për Ndihmë Ligjore Ndërkombëtare (NLN) ashtu edhe për ndihmë ligjore që i përkasin Serbisë dhe Malit të Zi.

<sup>52</sup> Para. 5, Qarkorja e Drejtësisë 2003/03.

<sup>53</sup> Para. 10 Qarkorja e Drejtësisë 2003/03 nën para. 11, Drejtori i DD-së nuk mund të garantoj që shtetet e adresuara do t'i procedojnë kërkesat për NLN brenda kësaj periudhe kohore. Megjithatë, Drejtori do t'i ndërmerr të gjitha masat që të reduktoj kohën e nevojshme për të transmetuar këto kërkesa.

<sup>54</sup> DD-ja e informoi Gjykatën Komunale në Mitrovicë për një letër të datës 14 prill 2006, ku ishte e kopjuar korrespondenca e Ministrisë së Drejtësisë në Serbi.

Më 14 shtator 2006, gjykata parashtroi edhe një kërkesë për NLN, që të ftohet pala.<sup>55</sup> Si pasojë, gati një vit e gjysmë ka kaluar qysh nga seanca e parë, e shtyrë në shtator të vitit 2005, dhe pala në Serbi ende nuk është ftuar. Edhe në rastin e skenarit më të mirë, duket se do të kalojnë vite para se ky kontest ligjor të përfundoj.

Në një rast tjetër të datës 4 prill 2006, pranë Gjykatës Komunale në Pejë që kishte të bënte me anulim të kontratës, gjykata më 2 maj 2006 kërkoi nga DD-ja që për seancën e ardhshme e cila do të mbahej më 14 shtator 2006, ta ftoj një dëshmitar i cili banon në Mal të Zi. Me gjithë këtë, seanca e shtatorit 2006 ishte shtyrë për shkak se DD-ja nuk e kishte informuar gjykatën se a është apo nuk është dërguar ftesa. Gjykata, për të dytën herë kërkoi nga DD-ja që ta ftoj dëshmitarin për seancën e ardhshme që do të mbahej më 16 janar 2007. Megjithatë, para asaj date DD-ja informoi gjykatën se fletëthirrja nuk mund të dorëzohet për arsye të vështirësive administrative dhe kërkoi nga ajo që ta ri-dërgoj kërkesën për Ndihmë Ligjore Ndërkombëtare (NLN). Kështu seanca ishte shtyrë për datë 22 maj 2007.

Më 30 gusht 2005 në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Prizren, paditësi parashtroi kërkesë për shkurorëzim nga bashkëshortja e tij e cila jetonte në Gjermani si dhe për përkujdesje ndaj fëmijës së tyre. Më 23 shkurt 2006, gjykata i dërgoi një kërkesë DD-së që ta ftoj bashkëshorten për seancën e ardhshme të datës 19 qershor 2006. Megjithatë, deri në atë datë, gjykata nuk kishte marrë përgjigje mbi atë se a ishte dërguar ftesa. Gjyqtari e shtyu seancën dhe përmes një letre tjetër të datës 19 qershor 2006 kërkoi nga DD-ja që t'i paraqes arsyet e këtij jo-komunikimi, letër e cila mbeti pa përgjigje. Më 2 tetor 2006 gjykata i dërgoi DD-së kërkesën e dytë që ta ftoj bashkëshorten për seancën e ardhshme që do të mbahet më 8 prill 2007. Deri nga fundi i muajit 2007, gjykata nuk ka marrë përgjigje nga DD nëse ftesa është dërguar.

Vonesat e tepërta në rastet e sipër përshkruara mund të shkaktojnë shkelje të së drejtës së palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Në rastin e parë kanë kaluar një vjet e katër muaj që nga kërkesa e parë drejtuar DD-së.<sup>56</sup> Në rastin e dytë, një periudhë prej më shumë se një vjet do të kalojë ndërmjet datës kur është dërguar kërkesa e parë në DD dhe seancës tjetër të caktuar për maj 2007. Në rastin e tretë, do të jetë më shumë se një vit e një muaj ndërmjet kërkesës drejtuar DD-së dhe seancës së ardhshme të gjykimit.

Edhe pse vonesat e shkaktuara nga autoritetet jashtë Kosovës nuk mund t'i vihen në barrë autoriteteve në Kosovë kur vendoset se a është shkelur parimi “koha e arsyeshme”, autoritetet në Kosovë duhet të jenë më pro-aktiv të sigurojnë që kërkesat për NLN të

<sup>55</sup> Gjykata megjithatë gabimisht i adresoi kërkesën për NLN Ministrisë së Drejtësisë në Kosovë në vend se të ja adresoj atë DD-së. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/53 e cila ndryshoi Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë e datës 20 dhjetor 2005, procedimi i kërkesave për NLN nuk bie mbi kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë. Kështu, autoriteti kompetent të cilit duhet adresuar kërkesat për NLN është ende DD-ja. Me gjithë këtë, Ministria e Drejtësisë në bazë të para. xiv nga aneksi i Rregullores do të “[n]dihmojë UNMIK-un kur kjo të jetë e përshtatshme, në ushtrimin e përgjegjësisë lidhur me bashkëpunimin ligjor ndërkombëtar...”

<sup>56</sup> Në total, kanë kaluar dy vjet e shtatë muaj në këtë rast që nga data e kërkesës për ri-gjykim. Asnjë seancë e gjykimit nuk është mbajtur për shkak se i padituri nuk është ftuar në mënyrë të rregullt..

ekzekutohen. Në bazë të praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, autoritetet nacionale duhet ta organizojnë sistemin e tyre juridik në mënyrë që gjykatat të jenë në pajtueshmëri me Konventën. Vështirësitë administrative nuk mund të justifikojnë shkeljet e KEDNJ-së.<sup>57</sup>

Për atë që u tha më lartë, OSBE rekomandon që:

- DD-ja duhet të luaj një rol më pro-aktiv të sigurojë që kërkesat për NLN të përfillen si dhe t'i minimizoj vonesat;
- DD-ja duhet t'i informoj gjykatat nëse janë dërguar fletëthirrjet para datës për kur është caktuar seanca;
- Gjykatat duhet t'i minimizojnë vonesat në procedurën e dërgesës së fletëthirrjeve dhe të ja adresoj DD-së kërkesat për NLN, si organ kompetent që i trajton kërkesat e tilla, e jo Ministrisë së Drejtësisë.

---

<sup>57</sup> Shih vendimin në *H. v. Mbretërisë së Bashkuar*, 9580/81, 8 korrik 1987, para. 85.